A) Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

B) Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme janë realizuar me subjekte private, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të Nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me pikën 4 të Nenit, 40 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: [...]*4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin, 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe pikën 4 të Nenit 40, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

1.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme ISO në përputhje me objektin e prokurimit, (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga DPA ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- **ISO 9001** për Menaxhimin e Cilësisë;
- **ISO 27001** për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit;

Shënim: Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të Nenit 79, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.* Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të Nenit 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.* Si dhe nisur nga proceset e punës kritike, rëndësisë së platformes dhe shërbimeve që ajo ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës së tij, ti bazojë në standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet të shërbimeve të ofruara.

ISO 9001: Sistemi i menaxhimit të cilësisë është i nevojshëm pasi siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e AK përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

ISO 27001: Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit është i nevojshëm pasi siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria, cka nisur nga rendesia dhe sensitiviteti i të dhënave që menaxhohen nepermjet sistemit objekt prokurimi, është një element jo vetëm i domosdoshëm por kritik.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që ka paktën **20 (njëzet)* punonjës të siguar**, ku të përfshihen jo më pak se **10 (dhjetë)* Inxhinierë/Specialistë** të diplomuar në degët Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni / Informatikë / Informatikë Matematikë / Inxhinieri Matematike dhe Informatikë, Informatikë Ekonomike / Telekomunikacion / Inxhinieri Telekomunikacion, që do të angazhohen në implementimin e projektit, ku të vërtetohen nëpërmjet **diplomës**.

Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 mujorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave. Me këtë numër minimal të kërkuar dhe synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe prandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj.). periudha minimale prej 3 muajsh punesim prane OE kerkohet per te vertetuar vazhdimesine e punes dhe kalimin e periudhes se proves sipas Kodit te Punes. Ky projekt eshte mjaft i rendesishem per mbarevajtjen e sistemit doganor.

***Shënim:** Kriteret për punonjësit në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomike do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST, në përmbushje të nenit 82, të Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM Nr. 285/2021, i ndryshuar.

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika (4) të LPP, ku parashikohet se: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin,*

punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Si dhe në nenin 41 pika 4 e VKM 285/2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

2.3.4. Për të vërtetuar aftësitë dhe kapacitetet teknike të punonjësve, operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti PMP nga PMI, ose Prince 2;**

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës të certifikuar si menaxher projekti, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira botërore duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të sistemit, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit. Projekt menaxheri, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, afatet kohore të kryerjes së shërbimit, shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, do të sigurojë që çdo pikë e shërbimeve të kërkuara të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të kësaj kontrate. Gjithashtu vlen të theksohet që me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe prandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj).

- b) Minimumi 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT, ITIL të lëshuar nga institucionet zyrtare ndërkombetare si Axelos ose PeopleCert**

Argumentimi: Kërkesa për një punonjës të certifikuar për “ITIL” ose ekuivalente lidhet me rezultatet që duhet të përmbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kërkesave të shprehura në DST ku përcaktohen kohët e ndërhyrjeve dhe termat e tjera të nivelit të shërbimit SLA (shërbimet e mirëmbajtjes). Një certifikim ITIL ose ekuivalente është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kërkesa për certifikim ITIL ose ekuivalente, i dëshmon autoritetit që operatori ekonomik, nëpërmjet stafit të certifikuar si më sipër, garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të projektit në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombetare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes.

- c) **Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar në nivelin profesional ose me te avancuar per pajisjet server, nga prodhuesi i pajisjeve server te ofertuar ;**

Argumentimi: Është e domosdoshme që operatori ekonomik të realizojë shërbimet e instalimit dhe konfigurimit pajisjeve hardware servera që do të ofrojnë, me cilësinë dhe profesionalizmin e duhur, duke patur parasysh rolin thelbësor që ka implementimi korrekt në nivel hardware i këtyre komponenteve, në arritjen e rezultateve të kërkuara në këtë projekt. Madhësia dhe kompleksiteti i projektit mund të menaxhohet duke patur të paktën dy punonjës me këto cilësi, të cilët të mbulojnë gjithë shërbimet e kërkuara, si gjatë implementimit ashtu edhe gjatë periudhës së mirëmbajtjes së projektit. Operatori duhet të dëshmojë që stafi i tij i zotëron këto aftësi teknike për pajisjet e prodhuesit të përzgjedhur për të ofertuar.

- d) **Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar në nivelin profesional ose me te avancuar për pajisjet Storage, nga prodhuesi i pajisjeve storage te ofertuar;**

Argumentimi: Është e domosdoshme që operatori ekonomik të realizojë shërbimet e instalimit dhe konfigurimit pajisjeve hardware storage dhe komponentet e tyre që do të ofrojnë, me cilësinë dhe profesionalizmin e duhur, duke patur parasysh rolin thelbësor që ka implementimi korrekt në nivel hardware i këtyre komponenteve, në arritjen e rezultateve të kërkuara në këtë projekt. Madhësia dhe kompleksiteti i projektit mund të menaxhohet duke patur të paktën dy punonjës me këto cilësi, të cilët të mbulojnë gjithë shërbimet e kërkuara, si gjatë implementimit ashtu edhe gjatë periudhës së mirëmbajtjes së projektit. Operatori duhet të dëshmojë që stafi i tij i zotëron këto aftësi teknike për pajisjet e prodhuesit të përzgjedhur për të ofertuar.

- e) **Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar për implementim, konfigurim, administrim të sistemeve të operimit Microsoft Windows Server ose Linux ose Unix nga prodhuesit e këtyre platformave ;**

Argumentimi: Gjatë projektit, do të kryhen shërbimet e kërkuara në instalimin apo konfigurimin në nivel OS të hardware ku do instalohen platformat software të institucionit, si dhe do duhet të ngrejnë shtresat e tjera të menaxhimit të kësaj infrastrukture bazuar në teknologji të ndryshme. Për këtë arsye është e domosdoshme që OE të ketë në stafin e tij të paktën punonjës me kualifikimet e mësipërme. Këta punonjës do të angazhohen gjatë fazës së implementimit si dhe gjatë mirëmbajtjes 2 vjeçare.

- f) **Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për platformën e ruajtjes dhe vendosjes së të dhënave (backup dhe restore) nga prodhuesi;**

Argumentim: Një nga detyrat e implementimit gjatë projektit, do të jetë edhe instalimi dhe konfigurimi i shërbimit backup dhe restore, si një komponente e rëndësishme e infrastruktures software në objekt të kontratës. Për këtë arsye është e domosdoshme që OE të ketë në stafin e tij të paktën 2 (dy) punonjës me kualifikimin e mësipërm. Këta punonjës do të angazhohen gjatë fazës së implementimit si dhe gjatë mirëmbajtjes 2 vjeçare. Është e domosdoshme që

certifikimet per platformen backup dhe restore te jene per platformen e ofertuar dhe te leshuara nga prodhuesi i perzgjedhur per te ofertuar.

- g) Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar per routing dhe switching ne nivel profesional ose me te avancuar, për pajisjet e tipit switch, nga prodhuesi i pajisjeve switch te ofertuar;**

Argumentimi: Gjate zhvillimit të projektit, për të mbeshtetur procesin e implementimit të pajisjeve në rrjet si dhe konfigurimet e nevojshme të pajisjet aktuale të rrjetit, do të jete e nevojshme që të behen konfigurime të niveleve të avancuara në pajisjet e rrjetit që do të mundesojne integrimin e pajisjeve dhe sisteme në objekt të ketij prokurimi. Keta punonjes gjithashtu do të kenë detyre mirembajtjen e ketyre pajisjeve dhe konfigurimeve të tyre, si për pajisjet në datacenter ashtu dhe për ato në deget e institucionit. Eshte e domosdoshme qe certifikimet e paraqitura te stafit, te jene te leshuara nga prodhuesi i perzgjedhur ne ofertim, per te siguruar se ata do te kene aftesite specifike dhe te nevojshme gjate zbatimit te kontrates.

- h) Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar në nivel profesional ose me te avancuar për konfigurime te pajisjeve të sigurisë së rrjetit të tipit firewall, nga prodhuesi i pajisjeve firewall te ofertuar;**

Argumentim: Gjate zhvillimit te projektit, per te mbeshtetur procesin e implementimit te nje numrin te madh pajisjesh firewall, si dhe duke patur parasysh edhe shperndarjen gjeografike te pikave ku do te kryhen sherbimet, do te jete e nevojshme qe te behen konfigurime te niveleve te avancuara ne vend. 2 punonjes te certifikuar jane minimumi i nevojshem per kryerjen e ketyre sherbimeve, dhe certifikimi qe mbajne do te jete nje element shtese per te garantur nivelin e cilesise se punes se tyre. Keta punonjes do te angazhohet gjate faze implementim si dhe gjate mirembajtjes 2 vjecare. Eshte e domosdoshme qe certifikimet e paraqitura te stafit, te jene per prodhuesin e perzgjedhur ne ofertim, per te siguruar se ata jane te aftesuar pikerisht per brandin e ofertuar.

- i) Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar për analizën proaktive të kërcënimeve dhe monitorimin e sigurisë si dhe per zbatimin e praktikave të sigurisë kibernetike, menaxhimin e rreziqeve dhe mbrojtjen e infrastrukturës IT.**

Argumentim: Kërkesa për minimumi 2 punonjës të certifikuar në analiza të kërcënimeve dhe siguri kibernetike është thelbësore për të garantuar monitorim të vazhdueshëm, identifikim proaktiv të rreziqeve dhe reagim të shpejtë ndaj incidenteve të sigurisë. Gjithashtu, këto kompetenca sigurojnë zbatimin korrekt të praktikave të sigurisë, menaxhimin efektiv të rreziqeve dhe mbrojtjen e qëndrueshme të infrastrukturës IT në përputhje me kërkesat e SLA dhe standardet ndërkombëtare.

**Shënim: Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 mujorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave.*

**Shënim: Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe prandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj.).*

**Shënim: Kriteret për punonjësit në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomike do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST, ne përmbushje të nenit 82, të Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM Nr. 285/2021, i ndryshuar.*

Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika (4) të LPP, ku parashikohet se: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

Si dhe në nenin 41 pika 4 e VKM 285/2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin. Autorizimi duhet të jetë në emër të Operatorit Ekonomik, dhe duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit si: Telefon, fax, e-mail, website. AK ka të drejtë të vërtetojë saktësinë e të dhënave të autorizimit. Autorizimi duhet të jete i vlefshëm, ne gjuhen shiqpe ose ate angleze, origjinal i përkthyer ose kopje e përkthyer dhe noterizuar.

Argumentim: Autorizim Prodhuesi ose Distributori rrit sigurinë që i ofrohet AK për mallra e kërkuar në këtë kontratë. Jo pa arsye, operatorët ekonomike lidhen me prodhuesit ndërkombëtarë, me qëllim uljen e kostove, marrjen e trajnimeve përkatëse për punonjësit edhe gjatë zbatimit të kontratës, marrjen e suportit në nivel prodhuesi në kohë reale. Si rrjedhojë, është kërkuar që marrëdhënia direkte e OE me Prodhuesin ose Distributorin e pajisjeve të jetë e domosdoshme në dobi të përdoruesve finalë dhe produkteve më cilësore, origjinale dhe me zbatim më rigoroz të garancisë, duke siguruar vijueshmëri në funksionalitetin e mëvonshëm sidomos në periudhën Post-Garanci.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vertetim, apo deklarate apo certifikate ku deshmohet qe gezon statusin e servisit te autorizuar per pajisjet hardware servers dhe storage

Argumentim: Kërkesa që Operatori Ekonomik të jetë servis i autorizuar nga prodhuesi për pajisjet server dhe storage është e nevojshme, pasi garanton që ndërhyrjet teknike, mirëmbajtja dhe riparimet kryhen nga personel i certifikuar sipas standardeve të prodhuesit, duke ruajtur integritetin, performancën dhe vlefshmërinë e garancisë. Gjithashtu, ky status siguron akses të drejtpërdrejtë në pjesë këmbimi origjinale, firmware, dhe mbështetje zyrtare, duke minimizuar kohën e ndërprerjes dhe duke garantuar përmbushjen e kërkesave të SLA-së në mënyrë të besueshme dhe të sigurt.

2.3.7. Pajisjet duhet të jenë të reja (JO Refurbished). Për këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë.

Argumentim: Duhet të garantohet që pajisjet e ofruara të jenë të reja, të asbluara me të gjitha pjesët origjinale të prodhuesit, modelet koherente, në përputhje me standardet evropiane. Për këtë arsye Operatori duhet të deklarojë që pajisjet e ofruara nuk janë Refurbished. Duke qenë se AKSHI është institucioni që prokuron pajisje IT dhe për institucionet e tjera, ka përgjegjësinë për sigurimin e pajisjeve të reja dhe shumë cilësore. Pajisjet Refurbished sjellin dëmtimin e shpejtë të tyre dhe jo efikasitet të këtyre pajisjeve, duke cenuar dhe besueshmërinë.

2.3.8. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit (ne gjuhen shqipe ose ate angleze) për produktin hardware që është objekt prokurimi. Në katalog, të markohen në menyrë të qartë dhe të dallueshme produkti që ofertohet sipas ofertës teknike të OE Ofertues. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentim: Kriteri i vendosura në DST është vendosur për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë produktet, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike si dhe është në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , i ndryshuar.

***Shënim:** Në rastet kur Operatori Ekonomik do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.